

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



DOKUMENT ORIENTUES PËRFSHIRJA DHE MOSDISKRIMINIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËRMES PUNËSIMIT



Version në gjuhë të thjeshtuar (easy-read)

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

RR. "Bogdani" , Nr1, Tiranë

Tel/Fax:+3554269426

www.info@adrf.al

E-mail: info@adrf.al

Disa nga figurat e këtij materiali janë prodhuar nga "Inspired Services Publishing Ltd"

Ky material është prodhuar në kuadër të Projektit "Shtrirja e Shërbimeve të Ndhmës Ligjore Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri", që zbatohet nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

Opinionet e shprehura në këtë material nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP, Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe as të partnerëve kombëtarë.

ÇFARË KA NË KËTË GUIDË?

1	Hyrje	4
2	Të dhëna për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.....	6
3	Legjislacioni për punësimin e personave me aftësi të kufizuara	7
4	Konkluzione	12
5	Rekomandime	13

1

HYRJE



E drejta për të punuar duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë për të gjithë.



Punësimi i personave me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë në nivele të ulta në shumicën e vendeve të botës.



Edhe kur personat me aftësi të kufizuara janë të punësuar, ata punësohen në pozicione me pagë më të ulët.



Personat me aftësi të kufizuara konsiderohen si “të papërshtatshëm” për tu punësuar njësoj si të tjerët.



Prandaj ata diskriminohen vazhdimisht në lidhje me punësimin.



Shumë personave me aftësi të kufizuara, ju mohohet e drejta për të punuar.

Neni 27 i KDPAK udhëzon shtetet:



a. të mos mosdiskriminojnë personat me aftësi të kufizuara pasi ata kanë të drejtë të punojnë në një bazë të barabartë me të tjerët;



b. të realizojnë aksesueshmërinë, duke identifikuar dhe hequr pengesat që pengojnë personat me aftësi të kufizuara që të kryejnë punën e tyre në mënyrë të barabartë bazë me të tjerët;



c. të realizojnë modifikime me qëllim lehtësimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara për të punuar në një bazë të barabartë me të tjerët;



d. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara të realizohet si në sektorin privat edhe në atë publik;

2

TË DHËNA PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHQIPËRI

Zyrat e Punësimit po ofrojnë një model të ri të shërbimeve të punësimit në tre nivele.

Në nivelin e tretë të shërbimeve, ekziston një këshillim individual edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Disa nga Zyrat e punësimit po bëhen të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Që nga viti 2014 ka vazhduar zbatimi i Programit sipas VKM nr. 248/2014 “Për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar”

Në katër vitet e fundit janë punësuar:

- a) 318 persona me aftësi të kufizuara gjatë zbatimit të këtij programi,
- b) 177 persona me aftësi të kufizuara janë punësuar nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim nga zyrat e punësimit, në shkallë vendi.

Formimi profesional ofrohet nga 10 qendrat publike të formimit profesional, në qytetet kryesore të vendit.

Në katër vitet e fundit janë përfshirë në kurse të formimit profesional 271 persona me aftësi të kufizuara dhe në arsimin profesional janë 266 persona me aftësi të kufizuara.

3

LEGJISLACIONI NË FUSHËN E PUNËSIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kodi i punës së Republikën e Shqipërisë ligj nr. Nr.7961, datë 12.7.1995 parashikon:

- a) Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë statusin e grupit të veçantë dhe kodi i jep një mbrojtje të posaçme;
- b) Kodi përfshin edhe aftësinë e kufizuar si një ndër shkaqet për të ndërrmarë veprime pozitive;
- c) Kodi ka përfshirë edhe detyrimin e përshtatjes së arsyeshme sipas rasteve.
- d) Zhvendos barrën e provës tek i padituri në rastet e diskriminimit.

Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”ka për qëllim të rrisë punësimin e forcave të punës, duke ofruar shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional. Në ligjin “Për nxitjen e punësimit” janë parashikuar disa dispozita për personat me aftësi të kufizuara: përshtatja e programeve dhe shërbimeve; nxitja përmes një trajtimi prioritar në punësim; aftësim dhe rehabilitim për punë; shërbime mbështetëse dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara.

Në ligj janë përfshirë konceptet e përshtatjes së arsyeshme dhe punësimit të përshtatur. Shërbimet e punësimit ofrohen në tre nivele pa pagesë për të gjithë përfituesit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara:

- a** shërbimet e informimit për punëkërkuarit, punëdhënësit dhe për çdo person të interesuar;
- b** ndërmjetësimi për punësim;
- c** këshillim dhe orientim për karrierë, punësim e profesion.

Ligji parashikon gjithashtu që informacioni ofrohet në forma dhe formate që janë të arritshme e të kuptueshme për punëkërkuarit persona me aftësi të kufizuara.

Ligji Nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, ka parashikuar krijimin e Fondit Social të Punësimit.

Fondi Social i Punësimit do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin për punë, aftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstruksion dhe përshtatje të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara.

Risi e ligjit është dhe përfshirja e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Ligji përmban detyrimin për respektimin e kuotave për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. çdo punëdhënës duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes; dhe nga një person shtesë për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes.

Ligji parashikon edhe penalizime të punëdhënësit në rast se nuk punëson numrin e përcaktuar të personave.

Ai detyrohet të derdhë një kontribut në Fondin Social të Punësimit të barabartë me 100 për qind të pagës minimale për çdo muaj, për çdo person që ai duhet të kishte punësuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Numër 17/2020 “Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale

Programi I

- a** Programi i punësimit është një program njëvjeçar punësimi ku përfitues janë edhe personat me aftësi të kufizuara.

Programi financon:

- 1** Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore
- 2** Financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi, për 12 (dymbëdhjetë) muaj për persona me aftësi të kufizuar të punësuar përmes këtij programi;

Programi II

- a** Programi i formimit nëpërmjet punës zgjat për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet;
- b** Cdo punëdhënës cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish, nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program;

Programi mbështet financiarisht:

- 1** Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të ofruara gjatë kohës së formimit;
- 2** Financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuar çdo muaj;
- 3** Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për tetë muajt e ardhshëm, kur, pas përfundimit të formimit

nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmuajore me punëmarrësin pas përfundimit të programit;

- ④ Pagesën për mentorin në vlerën 2 000 (dymijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës në program;

Programi III

- a) Programi i praktikave profesionale garanton tranzicion të shpejtë në tregun e punës, për një kohëzgjatje 6-mujore;
- b) Përfitues të këtij programi janë të gjithë punëkërkuarit e papunë, të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 24 (njëzet e katër) muajt e fundit pas diplomimit, të cilët janë regjistruar si punëkërkuar të papunë;
- c) Programi financon:
- d) Kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë;
- e) Financimin e pagës në shumën 50 (pesëdhjetë) % të pagës minimale;

Financime/Subvencione shpesh

- ① Bonuse për transportin për personat me aftësi të kufizuara që e kanë vendbanimin mbi 2 (dy) km larg nga vendi i punës, në vlerën prej 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;
- ② Deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar për punëdhënësit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Numër 348/2020 “Për programet e nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”

mbulon shpenzimet për:

- a** grantin për hapjen e biznesit të ri;
- b** vlerësimin e planeve të biznesit.

Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues, grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 535/2020 “Për programin e punëve publike në komunitet”.

Programi i punëve publike në komunitet është një program 12-mujor, i cili ofron mundësi të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet përfshijnë:

- a** shërbimet e kujdesit për fëmijët;
- b** shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social;
- c** shërbime të rehabilitimit të ish-përdoruesve të substancave narkotike;
- ç** punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin;
- d** shërbime këshillimi dhe informacioni;
- e** shërbime rinore;
- ë** sport;
- i** art, turizëm dhe kulturë.

Punëkërkuessit e papunë pjesëmarrës në këtë program angazhohen 20 orë në javë gjatë 5 (pesë) ditëve të javës.

Për punëkërkuessit e papunë pjesëmarrës në program financimet janë, si më poshtë vijon:

- a** Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale.
- b** Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
- c** Kupon për trajnim të punëkërkuessve të papunë pjesëmarrës në program deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;
- ç** Bonus për shpenzimet e transportit për ata që e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;

Financim deri në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara.

4

KONKLUZIONE

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara ka qenë dhe vazhdon të mbetet sfidë në Shqipëri.

Ofrohen mundësi të kufizuara për punësim.

Legjislacion është i fragmentuar, i paqartë dhe i paharmonizuar.

Modeli mjekësor ka lënë një vakum në kuadrin ligjor, ku parashikimet për rehabilitim apo riaftësim për punë, pothuajse nuk ekzistojnë.

Shërbime të tjera, që lidhen me jetesën e pavarur janë të pazhvilluara dhe kanë ndikimin e tyre negativ në punësimin ose frenimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Mungon një instrument i standardizuar për të bërë vlerësimin e duhur për aftësitë për punë të personave me aftësi të kufizuara.

Mungon vlerësimi edhe për vendin e punës.

Punonjësit e zyrave të punësimit nuk kanë kapacitetet e mjaftueshme profesionale.

“Akomodimi i arsyeshëm në vendin e punës” vazhdon të jetë një element i pa garantuar plotësisht për të punësuarit me aftësi të kufizuara.

Kërkimi i një pune apo ruajtja e një vendi pune, për një person me aftësi të kufizuara, kalon shpeshhere përmes paragjykimeve për aftësitë e tyre.

Mungesa e ndërgjegjësimit të punëdhënësve është gjithashtu një faktor i cili frenon marrjen e tyre në punë.

5


REKOMANDIME



Përfshirja e modelit bio-psiko-social, të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe konkretisht të aftësive të tyre për punën legjislaconin e punësimit;



Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me formimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.



Hartimi i një ligji të posaçëm për rehabilitimin dhe aftësimin e personave me aftësi të kufizuara, të lindur apo të bërë të tillë për shkaqe që lidhen me punësimin.



Krijimi i një instrumenti për vlerësimin nga ana e subjekteve zbatuese të ligjit për nxitjen e punësimit.



Rritja e kapaciteteve të stafeve të zyrave të punësimit dhe QFP-ve.



Punësimi i personave me aftësi të kufizuara nga institucionet publike, për të ofruar modele për subjektet private.



Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe promovuese me fokus punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

